



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALLAKASTËR
KËSHILLI BASHKIAK

Nr 6194 Prot.

Ballsh, më 26 / 12 .2024

VENDIM

Nr 66 Date 24 / 12 /2024

**PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË VITIT 2025 DHE NUMRIN E PËRGJITHSHEM TË
PUNONJËSVE ,DOKUMENTIN PËRFUNDIMTAR TË PROJEKT BUXHETIT
AFATMESEM 2025-2027.**

Këshilli Bashkiak Mallakastër pasi u njoh me relacionin dhe pasqyrat shoqëruese për “Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe numrin e përgjithshëm të punonjësve ,dokumentin përfundimtar të projekt buxhetit afatmesem 2025-2027.në zbatim të nenit 8 pika 2,nenit 9 pika 1,nënpikat 1.1 shkronja “b”,1.3 shkronja “c”,nenit 41 pika 1,neni 54 shkronja “c”,të ligjit Nr 139/2015 “Per Vetëqeverisjen vendore”,ligjin Nr 9936 date 26-08-2008 “Per menaxhimin e sistemit buxhetor ne Republiken e Shqiperise”,te ndryshuar,kreu III nenet 10-20, kreu IV nenet 20-29,kreu VII nenet 39-41 të ligjit Nr 68/2017 datë 27.04.2017 “Per Financat e Vetqeverisjes Vendore”,i ndryshuar,të ligjit nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”,Ligjin Nr 115/2024“Per Buxhetin e Vitit 2025”,nenin 9 të ligjit nr.35/2023 “Për kopentencat për caktimin e pagave ,trajtimeve të tjera financiare “,të ndryshuar,udhëzimit nr.23 datë 30.07.2018”Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njëjësive të vetqeverisjes vendore”,udhëzimit nr.3 datë 28.02.2024 i Ministrit të Financave “Për përgatitjen e buxhetit afatmesëm vendor 2025-2027 “,si dhe udhëzimit plotësues të Ministrisë së Financave “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2025-2027” i datës 19.06.2024,vendimeve të Këshillit Bashkiak nr.20 datë 28.03.2024 “Për miratimin e tavaneve përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2025-2027”,venidimit të Këshillit Bashkiak nr.33 datë 27.06.2024 “Për miratimin e dokumentit të parë të programit buxhetor afatmesëm 2025-2027”,vendimit të Këshillit Bashkiak nr.44 datë 25.09.2024 “Për miratimin e dokumentit të rishikuar të programit buxhetor afatmesëm 2025-2027”,vendimit të Këshillit Bashkiak nr.58 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2025:

VENDOSI:

1.Të miratojë Buxhetin e vitit 2025 ,dhe numrin e përgjithshëm të punonjësve të Bashkisë Mallakastër,si më poshtë:

1.1 Të miratoj numrin maksimal të punonjësve të Bashkisë Mallakastër dhe të institucioneve në varësi për vitin 2025 sisipas **Tabelës Raporti BV5** pjesë përbërëse e këtij vendimi..

1.2 Te miratoje planin e te ardhurave te vitit 2025,gjithsej ne vleren **898.112.260 (Tetëqind e nëntëdhjetë e tetë milionë e njëqind e dymbëdhjetë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë) leke**,sipas kësaj strukture të ardhurash:.

	<u>Në lekë</u>
- Të ardhurat nga Taksat dhe tarifat vendore	398.000.000
- Trasferta e Pakushtëzuar	259.466.649
- Trasferta Sektoriale	175.645.611
- Te ardhura të trashëguara	65.000.000
<u>TOTALI I TE ARDHURAVE</u>	<u>898.112.260 lekë</u>

1.3. Te miratoj detajimin e shpenzimeve për vitin 2025 gjithsej në vlerën **898.112.260** (Tetëqind e nëntëdhjetë e tetë milionë e njëqind e dymbëdhjetë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë) **lekë**, sipas kësaj strukture shpenzimesh:

	<u>Në lekë</u>
- Pagat e punonjësve	379.440.592
- Sigurime Shoqërore dhe shëndetësore	63.500.613
- Shpenzime operative	194.838.540
- Shpenzime kapitale	241.105.397
- Trasferime te Organizata dhe individë	5.500.000
- Fondi për Emergjencat Civile	11.227.118
- Fondi i kontigjencës	2.500.000
<u>TOTALI I SHPENZIMEVE</u>	<u>898.112.260 lekë</u>

1.4 Te miratoj Planin e të ardhurave për vitin 2025 sipas përputhshmërisë me rregullat fiskale në fuqi për vetëqeverisjen vendore sipas **Tabelës Raporti BV3**. pjesë përbërëse e këtij vendimi.

1.5 Te miratoj tavanet e shpenzimeve për çdo program për vitin 2025 sipas **Tabelës Raporti BV2** pjesë përbërëse e këtij vendimi.

1.6 Te miratoj detajimin e shpenzimeve për vitin 2025 në bazë të programeve dhe klasifikimeve buxhetore sipas **Tabelës Raporti BV6** pjesë përbërëse e këtij vendimi.

1.7 Te miratoj detajimin sipas zerave të investimeve sipas **Tabelës Raporti BV7** pjesë përbërëse e këtij vendimi.

1.8 Te miratoj njësitë shpenzuese sipas **Tabelës Raporti BV9** pjesë përbërëse e këtij vendimi.

2. Të miratoj dokumentin përfundimtar të programit buxhetor afatmesëm 2025-2027 sipas tabelave bashkalidhur.

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Bashkia Mallakastër.

4. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

KRYETAR
NEXHMI SULAJ

